


Inteligjenca Artificiale për Sektorin Tuaj dhe Tregun Global

Doracak Praktik

Publisher

This brochure has been developed by the project 'Enabling Income Generation for the Poor (EnInGeP)', financed by the Austrian Development Agency (ADA) and co-financed by the Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade.

Disclaimer

The information provided in this brochure is designed to provide helpful information on the subject discussed. It does not substitute for specific consulting, advisory services, legal and tax advice. We make no representation or warranty of any kind, regarding the accuracy, adequacy, validity, reliability, availability, or completeness of any information on the brochure. Any liability on the part of authors is therefore excluded

PËR KË ËSHTË KJO BROSHURË?

Kjo broshurë u dedikohet sipërmarrëseve dhe bizneseve të vogla, në Kosovë, që duan ta përdorin inteligjencën artificiale (AI) për të kursyer kohë në punën e përditshme dhe për të rritur shitjet e biznesit tuaj.

Pjesa e parë ju ndihmon të kuptoni se cilat platforma dhe mjete të AI mund t'i përshtaten sektorit tuaj, qoftë në tregti, modë, prodhim të ëmbëlsirave, gastronomi, artizanat apo shërbime profesionale. Pjesa e dytë fokusohet në mënyrën se si mund ta përdorni AI për të zhvilluar praninë digjitale, për të përmirësuar shitjet online dhe për t'u përgatitur për të hyrë në tregje ndërkombëtare.

Përmbajtja

	Kapitulli	Çfarë mësoni
1	Si të filloni	Formula e kërkesës dhe parimi "një mjet, një punë, një fitore"
2	AI për sektorin tuaj	Paketa 3-3-3, mjetet sipas sektorit, porositë, çmimet
3	Prania digjitale, shitja online dhe eksporti	Faqja e internetit (ueb-faqja), llogaritë e rrjeteve sociale të biznesit tuaj (Facebook, Instagram, TikTok), përshkrimet e produkteve/shërbimeve, Google SEO, klientët, eksporti
4	Përfitimet	Çfarë fitoni në kohë, kosto dhe arritje
5	Kufizimet dhe rreziqet	Ku gabon AI dhe si mbroheni
6	Kostot e mundshme	Sa kushtojnë mjetet dhe tri paketa shembull
7	Përdorimi i përgjegjshëm	10 rregulla dhe korniza ligjore
8	Plani 4-javor dhe fjalorthi	Si të filloni që nesër

Rregulla e artë: AI punon për ju — ju vendosni

AI nuk ju zëvendëson — AI merr përsipër punët e përsëritura, që ju të keni më shumë kohë për klientët dhe produktin. **Filloni me një platformë të AI dhe një detyrë konkrete, pastaj vlerësoni rezultatet**

SI TË FILLONI

Mënyra si e formuloni kërkesën (promptin) dhe detajet që i jepni platformës së AI janë thelbësore, sepse ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e përgjigjes. Përdorni gjithmonë këto pesë pjesë:

Pjesa	Si të komunikoni me AI	Shembull
1. Roli	Kush duhet të "jetë" AI	"Vepro si krijues tekstesh për shitje online…"
2. Konteksti	Produkti, sektori, qyteti, klientët	"…për sapun natyral me lavandë, të punuar me dorë në Kosovë"
3. Detyra	Çfarë saktësisht doni	"Shkruaj përshkrimin e produktit për faqen e internetit"
4. Formati	Gjatësia e tekstit, gjuha, toni	"Maksimum 80 fjalë, në shqip dhe anglisht, ton i ngrohtë"
5. Kontrolli	Kufijtë dhe transparenca	"Mos shpik përbërës; shëno çfarë duhet ta plotësoj vetë"

Pse ia vlen

Nevoja	Dikur	Sot me AI
Tekstet dhe postimet	Krijues/e i/e përmbajtjes me pagesë	Draft në sekonda
Fotografitë e produkteve	Fotograf/e profesional/e	Gjenerim I fotove profesionale me AI Brenda minutave
Faqja e internetit	Dizajner/e uebi, disa javë	Uebfaqe gati brenda disa orëve
Gjetja në Google (SEO)	Specialist/e SEO	Fjalë kyçe dhe tituj të sugjeruar
Përkthimi	Përkthyes/e	Përkthim i menjëhershëm (që zakonisht duhet rishikuar)

AI PËR SEKTORIN TUAJ

Çdo sektor ka punë që përsëriten: porositë, rezervimet, çmimet, fotot, përshkrimet. Metoda 3-3-3 ju ndihmon t'i organizoni: 3 mjete, 3 përdorime dhe 3 mënyra për të kursyer kohë.

Udhëzimi 1 — Ndërtoni paketën tuaj 3-3-3

1. **Shkruani pengesat:** cilat 3 punë ju marrin më shumë kohë çdo javë? (p.sh. përgjigjet në mesazhe, llogaritja e çmimeve, postimet).
2. **Zgjidhni 3 mjete** (AI tools) nga tabela më poshtë — f filloni punën duke shfrytëzuar versionin falas që ofrojnë shumica e platformave
3. **Përshkruani 3 përdorime konkrete** për biznesin tuaj (jo të përgjithshme).
4. **Përcaktoni 3 kursime kohe** dhe sa orë në javë pritet të kursejnë.
5. **Shkruani një shembull real:** si do të duket puna juaj e nesërme me këtë mjet.
6. **Provojeni për 2 javë** dhe shënoni sa kohë keni kursyer realisht.

KËRKESË E GATSHME

Kam një biznes të vogël [p.sh. ëmbëlsira me porosi] në [qyteti], me [numri] punonjës. Punët që më marrin më shumë kohë janë: [1], [2], [3].

Më sugjero 3 mjete AI falas ose me kosto të ulët që funksionojnë në Kosovë, 3 mënyra konkrete si t'i përdor dhe sa kohë mund të kursej në javë. Shkruaj në shqip, në tabelë.

Mjetet e qasshme sipas sektorit (zgjedhjet e rekomanduara për Kosovë)

Sektori	Mjetet	Përdorimet kryesore	Ku kurseni kohë
Tregti me pakicë	ChatGPT, Canva AI, Shopify	Përshkrime produktesh, materiale promocionale, shitje te diaspora	Përditësim më i shpejtë i katalogut
Stiliste dhe dizajnere mode	ChatGPT + Canva AI, Pinterest Trends, Instagram Shopping	Variante dizajni, ndjekje e trendeve, etiketim i produkteve	Variante në minuta, jo në ditë
Ëmbëlsira dhe torte	ChatGPT, WhatsApp Business, Canva AI	Llogaritja e çmimit, porositë, menu dhe portofol	Rrjedhë e rregullt porosish
Hoteleri dhe gastronomi	WhatsApp Business, Google Business Profile, ChatGPT	Rezervime, përgjigje ndaj vlerësimeve, menu dhe oferta ditore	Më pak ndërprerje telefonike
Shërbime (bukuri, këshillim, mirëqenie)	Calendly, WhatsApp Business, ChatGPT	Rezervime online, kujtesa automatike, shënime për klientët	Më pak takime të humbura
Artizanë	ChatGPT, Canva AI	Historia e produktit, foto profesionale, paketim	Listime produktesh nga një foto
Shërbime profesionale	Canva AI, ChatGPT, Calendly	Oferta, raporte, email-e, përmbledhje takimesh	Formatim automatik i dokumenteve

Ekzistojnë edhe mjete të specializuara (p.sh. Slang.ai për telefonatat në restorante, MarketMan për kostot e recetave, Cala për modë, Cakenote për ëmbëlsira). Shumica janë në anglisht, me pagesë dhe të ndërtuara për tregje të tjera.

Udhëzimi 2 — Porositë dhe rezervimet me WhatsApp Business

WhatsApp Business është falas, përdoret gjerësisht në Kosovë dhe mund t'ju kursejë disa orë në javë. AI ju ndihmon të shkruani mesazhet; WhatsApp-i i dërgon automatikisht.

1. **Shkarkoni WhatsApp Business** dhe plotësoni profilin: përshkrimi, orari, adresa, faqja e internetit.
2. **Krijoni katalogun** me foto, çmim dhe përshkrim të shkurtër për çdo produkt ose shërbim.

3. **Vendosni mesazhin e mirëseardhjes** dhe **mesazhin e mungesës** (kur jeni jashtë orarit).
4. **Krijoni përgjigje të shpejta** për pyetjet e shpeshta: çmimet, dërgesa, afatet e porosisë.
5. **Përdorni etiketat** ("Porosi e re", "E paguar", "Dërguar") që të mos humbisni asnjë porosi.

KËRKESË/PROMPT I REKOMANDUAR PËR MESAZHET AUTOMATIKE NDAJ KLIENTËVE

Shkruaj 6 përgjigje të shkurtra dhe miqësore për WhatsApp Business për një biznes tortash me porosi në Prishtinë: mirëseardhja, mesazhi jashtë orarit, çmimet, afati i porosisë (minimum 3 ditë), dërgesa dhe konfirmimi i porosisë. Në shqip, maksimum 40 fjalë secila. Përdor gjuhë neutrale që i drejtohet çdo klienti me 'ju', pa supozime për gjininë apo moshën e tij/saj.

Udhëzimi 3 — Llogaritja e çmimit të produktit

Shumë biznese të vogla e vendosin çmimin "me sy". AI ju ndihmon të mos harroni asnjë kosto. Shembull: tortë për 12 persona.

Kostoja	€	Kostoja	€
Përbërësit	9.50	Energjia (furra)	1.50
Kutia dhe dekorimi	3.00	Puna: 3 orë × €5	15.00
		Kostoja totale	**29.00**

Mësim nga praktika: një fjalë e paqartë ndryshon çmimin

Nëse i thoni AI-së "shto 30% fitim", ajo mund të llogarisë **€29 × 1.30 = €37.70**. Por nëse doni që 30% e **çmimit të shitjes** të jetë fitim, çmimi duhet të jetë **€29 ÷ 0.70 = €41.43**. Dallimi është afër €4 për çdo tortë. Shkruani gjithmonë qartë: *"marzh 30% e çmimit të shitjes"* dhe kontrollojeni llogaritjen vetë.

PRANIA DIGJITALE, SHITJA ONLINE DHE EKSPORTI

Klienti juaj mund të jetë kudo — në Prishtinë, në Berlin apo në Zyrih. Interneti i ka hequr kufijtë; AI e bën më të lehtë punën që duhet për t'i arritur. "Vitrina" juaj digjitale ka katër pjesë:

Instagram dhe Facebook	Faqja e internetit	Google Business Profile	Vlerësimet e klientëve
Imazhi i markës dhe dëshmia që klientët ju besojnë	Dyqani juaj i hapur 24 orë dhe besueshmëria	Si ju gjejnë klientët për herë të parë	Sinjali i besimit që vendos blerjen

Udhëzimi 4 — Krijoni uebfaqen tuaj me AI (Wix – https://wix.com/ ose Squarespace – https://squarespace.com/)

1. **Përgatitni materialin:** logon e biznesit, 5–10 foto të mira, listën e produkteve me çmime, kontaktin.
2. **Hapni një llogari** në Wix (ka plan falas) ose Squarespace dhe zgjidhni krijimin me AI. Paneli i Wix dhe Squarespace janë në anglisht, por faqen mund ta shkruani në shqip. Kujdes: Wix Payments nuk funksionon në Kosovë, ndërsa Squarespace pranon pagesa online vetëm përmes Stripe dhe PayPal,
3. **Përshkruani biznesin në një fjali** (shih kërkesën më poshtë). AI krijon faqet, tekstet dhe dizajnin.
4. **Zëvendësoni** fotot dhe tekstet e përgjithshme me ato tuajat — AI nuk e njeh produktin tuaj.
5. **Shtoni gjuhët që flasin klientët tuaj** (p.sh. anglisht, ose gjermanisht për diasporën) dhe kontrolloni si duket faqja në telefon, sepse shumica e klientëve e hapin faqen nga telefoni**.**
6. **Publikojeni** dhe lidheni me llogaritë tuaja në Instagram, WhatsApp dhe Google Business Profile.

KËRKESË E GATSHME

Krijo një faqe interneti moderne për një biznes që prodhon me dorë bizhuteri, i dedikuar grave 25–45 vjeç në Kosovë dhe në diasporë. Faqet: Ballina, Produktet, Rreth nesh, Kontakti. Ton elegant dhe i ngrohtë. Përdor imazhe dhe tekste që përfaqësojnë gra të moshave, pamjeve dhe stileve të ndryshme, pa stereotipe. Shto përshkrim për çdo foto dhe përdor kontrast të mirë ngjyrash që faqja të jetë e lexueshme edhe për persona me shikim të dobët.

Udhëzimi 5 — Një kërkesë, katër materiale shitjeje

Me një kërkesë të vetme mund të merrni: përshkrimin e produktit, postimin për Instagram, tekstin për faqen e internetit dhe reklamën për Facebook.

	Përshkrim i thjeshtë	**Përshkrim i përmirësuar me AI**
Teksti	"Sapun me lavandë, i bërë me dorë."	« Sapun natyral me vaj lavande, i punuar me dorë në Kosovë. Pastron dhe hidraton lëkurën, ndërsa aroma e lavandës ju sjell qetësi çdo ditë. Porositni sot! »
Përmban	Vetëm përbërësin	Përfitimet, përbërësit, fjalët kyçe dhe thirrjen për veprim
Rezultati	Pak vëmendje, pak shitje	Më shumë besim, gjetje më e lehtë në Google, më shumë blerje

KËRKESË E GATSHME

Vepro si krijues tekstesh për shitje online. Produkti: sapun natyral me lavandë, i punuar me dorë në Kosovë. Klientët: gra 25–50 vjeç që preferojnë kozmetikë natyrale.

Shkruaj: (1) përshkrimin e produktit, (2) postimin për Instagram me hashtag-ë, (3) tekstin për faqen e internetit, (4) reklamën për Facebook. Përfshi përfitimet, përbërësit, fjalët kyçe dhe thirrjen për veprim. Mos shto përbërës ose veti që nuk i kam përmendur. Mos përdor stereotipe gjinore ose standarde të ngushta bukurie. Nëse sugjeron imazhe, përfshi njerëz të moshave dhe pamjeve të ndryshme dhe shkruaj për to.

Këshillë për artizanët: bëni një foto të produktit me telefon, hiqni sfondin me Canva dhe kërkoni nga AI titullin, përshkrimin dhe etiketat për listim — nga një foto, në pak minuta. Fotoja duhet ta tregojë produktin real; mos përdorni fytyra të njerëzve realë pa pëlqimin e tyre. Canva mund të integrohet me ChatGPT për të kombinuar krijimin e teksteve dhe ideve me dizajnimin e materialeve vizuale për biznesin.

Udhëzimi 6 — Bëhuni të gjetshëm në Google (SEO e thjeshtë)

SEO është mënyra si e ndihmoni Google ta kuptojë biznesin tuaj, që t'ua shfaqë klientëve kur kërkojnë atë që ju ofroni. Me tituj dhe përshkrime të qarta, klientët ju gjejnë vetë, pa paguar për reklama.

Elementi	Shembull i dobët	Shembull i mirë
Titulli i faqes	Tortë e punuar me dorë	Torta dasme me porosi në Prishtinë Ëmbëlsira të freskëta
Emri i produktit	Sapun	Sapun natyral me lavandë – punuar me dorë në Kosovë
Përshkrimi	Fustan i bukur në shitje	Fustan elegant i qepur me dorë për dasma, në Prishtinë

- **Fjalët kyçe:** "Më jep 10 fjalë kyçe që klientët kërkojnë në Google për bizhuteri të punuara me dorë në Kosovë."
- **Titujt:** "Shkruaj 5 tituj faqesh për një biznes tortash dasme në Prishtinë."
- **Blogu:** "Sugjero 5 tema artikujsh për një markë kozmetike natyrale" (p.sh. "Sa kohë përpara duhet porositur torta e dasmës?").
- **Pyetjet e shpeshta:** "Krijo 8 pyetje e përgjigje të shpeshta për një dyqan online sapunësh natyralë."

Udhëzimi 7 — Shërbimi ndaj klientit: asistenti automatik, vlerësimet dhe kthimet

a) Asistenti automatik i bisedës (chatbot) — përgjigje 24 orë

UDHËZIMI PËR ASISTENTIN

Ti je asistent/e i/e shërbimit ndaj klientit për një biznes kozmetike natyrale në Kosovë. Përgjigju në mënyrë miqësore dhe profesionale, në shqip ose anglisht, sipas gjuhës së klientit.

Përdor vetëm këto informacione: [orari, çmimet, dërgesa, politika e kthimit]. Nëse nuk e di përgjigjen, thuaj që do ta kontaktojë një person nga ekipi. Mos premto zbritje. Trajto çdo klient me respekt të barabartë, përdor gjuhë neutrale dhe mos bëj supozime për gjininë, moshën ose origjinën e klientit. Prezantohu si asistent automatik.

b) Vlerësimet e klientëve — hulumtim tregu falas

Kopjoni deri në 100 vlerësime (nga Google, Facebook ose platformat e shitjes), hiqni emrat e klientëve dhe kërkoni: "Gjej 5 ankesat më të shpeshta, 5 gjërat që klientët i pëlqejnë më shumë dhe 5 ide konkrete përmirësimi."

c) Kthimet dhe ankesat

"Një klient dëshiron të kthejë një fustan sepse masa nuk i përshtatet. Shkruaj një përgjigje miqësore e profesionale në shqip dhe anglisht, me hapat e kthimit dhe ofertën për ndërrim." Përgjigjja e mirë ka: mirëkuptim, hapa të qartë, zgjidhje dhe një mbyllje pozitive.

Tregu online (e-commerce) në Kosovë — çfarë duhet të dini

- **Platformat lokale:** në Kosovë ka disa platforma online ku mund t'i listoni produktet tuaja pa ndërtuar dyqanin tuaj online. Kjo është një mënyrë e mirë për të filluar, sepse platforma i ka tashmë klientët.
- **Pagesat:** shumica e klientëve ende preferojnë pagesën në dorëzim. Ofroni edhe mënyra të tjera: transfertë bankare, pagesë me kartë (Visa, Mastercard), pagesë përmes platformave që funksionojnë në Kosovë si Paysera, ose Google Pay dhe Apple Pay përmes bankave që i ofrojnë. Para se të zgjidhni, pyesni bankën tuaj cila mënyrë pagese online i përshtatet më mirë biznesit tuaj.
- **Besimi:** frika nga mashtrimi dhe pritjet e larta për dërgesën janë pengesat kryesore. AI nuk ndërton besim — ju e ndërtoni me qëndrueshmëri, transparencë dhe shërbim të mirë.

Udhëzimi 8 — Gati për eksport: tri pengesa, tri zgjidhje me AI

Pengesa	Si ndihmon AI	Shembull
1. Hulumtimi i tregut	Krahason vendet sipas kërkesës, konkurrencës, çmimeve dhe pritjeve të klientëve	"Prodhoj me dorë kozmetikë natyrale në Kosovë. Cilat tregje evropiane kanë kërkesë më të lartë për kujdes natyral të lëkurës?"
2. Përkthimi	Përkthen dhe ia përshtat tonin çdo tregu (anglisht, gjermanisht, italisht)	"Sapun natyral me lavandë" → *"Natürliche Lavendelseife, handgefertigt in Kosovo — sanft, pflegend und nachhaltig."*
3. Dokumentacioni	Harton draftin e faturës tregtare, listës së	Draft i gatshëm që e kontrollon një ekspert ose

	paketimit, faturës proforma	agjenti doganor

Shembull i krahasimit të tregjeve (rezultat nga AI — verifikojeni)

	Gjermania	Austria	Zvicra
Fuqia blerëse	E lartë, klientë që shikojnë vlerën	E lartë, fokus te cilësia	Shumë e lartë
Çfarë vlerësojnë	Cilësi, funksionalitet, produkte miqësore me mjedisin	Produkte artizanale, autentike, vendore	Produkte të veçanta, mjeshtëri e lartë, origjinalitet
Qëndrueshmëria	Shumë e rëndësishme	E rëndësishme	Thelbësore
Ndjeshmëria ndaj çmimit	Mesatare	E ulët	Shumë e ulët

: Rast ilustrues: nga tregu lokal te klientët në Austri

2024: shiste vetëm në Prishtinë → 2025: hapi dyqanin në Instagram dhe bëri shitjet e para online → 2026: me AI përgatiti përshkrime në gjermanisht dhe mori porositë e para nga Austria → **objektivi për 2027: 30% e të ardhurave nga eksporti.** Mësimi kryesor: AI hoqi pengesën e gjuhës dhe të marketingut.

Kujdes para eksportit: AI përgatit, ekspertët verifikojnë

- **Kozmetika në BE** : Përpara se ta vendosni produktin në treg, kontrolloni kërkesat për personin përgjegjës në BE, vlerësimin e sigurisë dhe njoftimin në portalin CPNP, sipas Rregullores (KE) nr. 1223/2009. Pretendimet si "bio" ose "organik" duhet të jenë të sakta dhe të mbështeten me dëshmi përkatëse.
- **Eksporti në Zvicër:** Zvicra nuk është pjesë e BE-së dhe zbaton kërkesat e veta doganore dhe të produkteve. Kontrolloni rregullat që vlejnë për produktin tuaj përpara se të eksportoni.
- **Shitja përmes platformave online: Etsy Payments** nuk është aktualisht i disponueshëm për shitësit me seli në Kosovë, ndërsa **Shopify Payments** nuk mbështet bizneset e regjistruara në Kosovë. Megjithatë, shitësit mund të shqyrtojnë ofrues alternativë të pagesave, si **Raiffeisen Payment Gateway**, i cili mundëson integrimin e zgjidhjes së pagesave me dyqanin online në Shopify. Kjo zgjidhje ofron konfigurim të thjeshtë, përditësime automatike të pagesave dhe një proces të sigurt e të lehtë të pagesës për klientët, drejtpërdrejt përmes dyqanit online. Përpara se të zgjidhni platformën ose ofruesin e pagesave, verifikoni kushtet e përdorimit, disponueshmërinë në Kosovë dhe kërkesat për hapjen e llogarisë së biznesit. **Dokumentet e eksportit:** Dokumentet e origjinës dhe dokumentet e tjera doganore duhet të përgatiten sipas rregullave që zbatohen për produktin dhe tregun e destinacionit. Për kërkesat konkrete, drejtojuni **Dogana e Kosovës**, **KIESA** dhe **Odës Ekonomike të Kosovës**.

PËRFITIMET

Përfitimi	Në sektorin tuaj	Në shitjen online dhe eksport
Kursim kohe	Porosi, rezervime dhe mesazhe automatike	Uebfaqe profesionale e gjeneruar brenda disa orësh, jo javëve
Kosto më e ulët	Shumë platforma falas (WhatsApp Business, Canva, ChatGPT)	Pa pagesë për krijues përmbajtjesh, fotograf, përkthyes për çdo detyrë
Pamje profesionale	Menu, katalogë dhe oferta të rregullta	Foto, përshkrime dhe tekste në nivel të markave të mëdha
Më pak klientë të humbur	Përgjigje të menjëhershme, kujtesa për takime	Asistent automatik 24 orë, në disa gjuhë
Vendime më të mira	Çmime të llogaritura saktë	Analizë vlerësimesh dhe tregjesh pa agjenci të shtrenjtë
Arritje më e gjerë	Klientë të rinj në qytetin tuaj	Diaspora dhe tregjet evropiane

KUFIZIMET DHE RREZIQET

Kufizimi	Çfarë do të thotë	Si mbroheni
Fakte të shpikura	AI mund të shtojë përbërës, veti ose rregulla që nuk ekzistojnë	Lexoni çdo tekst para publikimit
Llogaritje të paqarta	Ngatërron marzhin me shtesën mbi kosto (shih Udhëzimin 3)	Rillogaritni vetë çmimet
Përkthime të ngurta	Gabime ose ton i papërshtatshëm për tregun	Rishikim nga një folës/e vendas/e
Tekste të njëjta me të tjerët	Tekst i përgjithshëm që nuk ju dallon	Shtoni historinë dhe zërin tuaj
Asistenti automatik gabon	Jep informacion të gabuar ose premton gjëra që nuk i ofroni	Kufizojeni te informacioni juaj; kontrolloni bisedat
Rregullat e eksportit	AI nuk i njeh mirë kërkesat ligjore dhe doganore	Konsultohuni me ekspertë dhe institucione
Varësia nga platformat	Ndryshimet në Instagram ose në tarifat e platformave	Kini faqen tuaj dhe listën e klientëve

KOSTOT E MUNDSHME

Çmimet ndryshojnë shpesh, zakonisht janë në dollarë ose euro dhe pa TVSH. Shifrat janë **orientuese (tetor 2026)** — kontrollojini në faqen zyrtare para blerjes. Të gjitha çmimet janë dhënë në euro, të përafërta (tetor 2026). Shumë mjete faturohen në dollarë amerikanë, prandaj shuma e saktë varet nga kursi i këmbimit dhe TVSH-ja. Kontrollojini në faqen zyrtare para blerjes."

Mjeti	Versioni falas	Versioni me pagesë (në muaj)
WhatsApp Business	Po	Aplikacioni bazë: falas
Google Business Profile	Po	Falas
ChatGPT	Po	Go: rreth 8 €; Plus: rreth 20 €
Claude	Po	Pro: rreth 18–20 €
Gemini / Google AI	Po	Google AI Pro: rreth 22 €
Canva	Po, me kufizime në funksionet AI	Çmimi ndryshon sipas rajonit
Calendly	Po, plan bazë	Çmimi ndryshon sipas planit
Wix	Po, me adresë Wix	Nga rreth 15–20 €
Squarespace	Provë falas	Çmimi ndryshon sipas planit
Shopify	Provë/ofertë hyrëse	Basic: 24 €/muaj me faturim vjetor ose 32 €/muaj me faturim mujor
DeepL	Po, me kufizime	Nga 7,49 €/muaj me faturim vjetor

Kostot "e fshehura"

- Komisionet e platformave të shitjes dhe tarifat e pagesave me kartë.
- Dërgesa dhe paketimi — sidomos për eksport.
- Reklamat në Facebook/Instagram (buxhet më vete, që e vendosni ju).
- Koha për të mësuar, për të kontrolluar tekstet dhe për t'iu përgjigjur klientëve.

Tri paketa shembull

Paketa	Çfarë përfshin	Kosto e përafërt
Fillestare	Instagram/Facebook, WhatsApp Business, Google Business Profile, ChatGPT dhe Canva falas	€0 / muaj
Bazë	Faqe në Wix me domenin tuaj + Canva Pro ose një abonim AI	≈ €30–60 / muaj
Eksport	Dyqan online (Shopify ose Wix për biznes) + AI + Canva Pro + DeepL Pro	≈ €80–150 / muaj + reklama

REKOMANDIME PËR PËRDORIM TË PËRGJEGJSHËM

- **Vërtetësia mbi të gjitha:** përshkrimet dhe fotot duhet ta paraqesin produktin ashtu siç është. Mos shtoni veti që nuk i ka.
- **Mos përdorni deklarata pa bazë** si "bio", "organik", "kurues" ose "100% natyral" pa certifikim ose dëshmi.
- **Asnjëherë vlerësime të rreme.** Mos kërkoni nga AI të shkruajë vlerësime në emër të klientëve.
- **Tregoni kur klienti flet me AI.** Asistenti automatik duhet të prezantohet si i tillë dhe të ofrojë kontakt me një person.
- **Mbroni të dhënat e klientëve:** hiqni emrat, telefonat dhe adresat para se t'i ngjitni në mjetet AI.

- **Respektoni të drejtat e autorit:** mos kopjoni foto, logo ose dizajne të të tjerëve; përdorni fotot tuaja ose ato me licencë.
- **Rishikoni përkthimet** me një folës/e vendas/e para publikimit në tregje të reja.
- **Verifikoni dokumentet e eksportit** me ekspertë dhe institucionet përkatëse.
- **Matni rezultatin:** orët e kursyera, porositë dhe klientët e rinj — mbani vetëm mjetet që ju shërbejnë.
- **Ruani zërin tuaj**: AI harton, ju personalizoni. Historia juaj është ajo që shet.
- **Marketing gjithëpërfshirës dhe i qasshëm**: kontrolloni që tekstet dhe imazhet e krijuara me AI të përfaqësojnë gra dhe burra në role të ndryshme, mosha dhe komunitete të ndryshme; shtoni alt-tekst për fotot, titra për videot dhe ofroni kontakt edhe me telefon ose WhatsApp për ata që nuk kanë internet të mirë ose përvojë me teknologjinë.
- **Siguria online**: mbani llogari të veçanta për biznesin me verifikim me dy hapa; publikoni vetëm foto me pëlqimin e personave.

Korniza ligjore në shkurt (kjo nuk është këshillë ligjore)

- **Kosovë:** Ligji Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (mbikëqyrës: Agjencia për Informim dhe Privatësi).
- **Klientët në BE:** vlen Rregullorja e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave (GDPR); rregullat e BE-së për konsumatorët ndalojnë vlerësimet e rreme.
- **Akti i BE-së për AI** kërkon që njerëzit të informohen kur komunikojnë me një sistem AI.
- **Produktet** (kozmetikë, ushqim, tekstile) kanë rregulla të veçanta për etiketim dhe siguri në çdo treg.

Plani 4-javor për të filluar

Java	Hapi	Çfarë bëni
1	**Zgjidhni**	Zgjidhni 1–3 mjete nga lista e sektorit tuaj dhe regjistrohuni në versionin falas.
2	**Shkruani procesin**	Zgjidhni një punë që përsëritet (p.sh. përgjigjet për porositë) dhe shkruani hapat e saj.
3	**Zbatoni**	Provoni mjetin në atë punë dhe përmirësoni kërkesat derisa rezultati t'ju pëlqejë.
4	**Matni**	Shënoni orët e kursyera dhe përmirësimet; vendosni çfarë mbani dhe çfarë shtoni.

Ushtrim Praktik: Plani im i eksportit (plotësojeni)

Pyetja	Përgjigjja ime
Produkti që dua të eksportoj	
Vendi që synoj	
Mjetet AI që do të përdor	
Gjuhët e faqes sime	

Hapi i parë nesër në mëngjes	

Fjalorth i shkurtër

Termi	Kuptimi i thjeshtë
Tregti elektronike (e-commerce)	Shitja dhe blerja e produkteve përmes internetit
SEO	Përshtatja e uebfaqes që Google ta gjejë dhe ta shfaqë më lart
Fjalë kyçe	Fjalët që klientët shkruajnë në Google kur kërkojnë një produkt
Asistent automatik (chatbot)	Program që u përgjigjet klientëve automatikisht, me tekst
Treg online (marketplace)	Platformë ku shumë shitës shesin produktet e tyre (e-commerce)
Thirrje për veprim (call-to-action)	Fjalia që e fton klientin të veprojë: "Porositni sot!"
Pagesë në dorëzim	Klienti paguan me para në dorë kur e merr porosinë

Mesazhi përmbyllës

Filloni me një mjet (AI Tool), për një punë, dhe matni rezultatin. Pas disa javësh, shikoni sa kohë keni kursyer dhe vendosni çfarë mbani. AI-ja ju ndihmon të punoni më shpejt, por vendimet dhe besimi i klientëve mbeten në duart tuaja. Hapi i parë mund të bëhet sot